



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 2025

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. _____, datë _____. _____. 2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË
PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË REZULTATEVE NË PUNË PËR 6-
MUJORIN E DYTË TË VITIT 2024, SI DHE GJATË ECURISË DISIPLINORE, NË
INSTITUCIONIN E AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE DHE
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR
PALIGJSHMËRINË E KONSTATUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunës Pranvera Hajdini, në institucionin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 600 prot., datë 11.6.2025, nëpërmjet të cilit nëpunësja Pranvera Hajdini, me detyrë “Shefe në Sektorin e Buxhet-Financës”, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, ngre pretendime për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë

procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për 6- mujorin e dytë të vitit 2024, që përkon me periudhën 1.7.2024 - 31.12.2024, si dhe gjatë procedurës së ndjekur për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, nga ana e eprorit direkt, në ngarkim të nëpunës.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, parashtrohet se, me vendimin nr. 342, (nr.1851/4 prot.), datë 28.5.2025 “Për dhënien e masës disiplinore një punonjësi të AMP-së”, të eprorit direkt është vendosur dhënia e masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunës Pranvera Hajdini, me motivacion: “Shkelje e rregullave të etikës” dhe “Sjellje e parregullt, gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, varësit dhe publikun”.

Në informacionin e dërguar, nëpunësja parashtron se, motivacioni për shkelje të disiplinës në punë, për të cilin ka nisur edhe ecuria disiplinore, është ngritur mbi akuza të pavërteta dhe të paargumentuara nga eprori, në kushtet e konfliktit të interesit pasi ky zyrtar ka ndjekur edhe procesin e ecurisë disiplinore, e për pasojë, masa disiplinore e dhënë në ngarkim të saj, është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni që rregullon institutin e disiplinës në shërbimin civil.

Gjithashtu, sa i takon vlerësimit të rezultateve në punë për 6-mujorin e dytë Korrik-Dhjetor 2024, vlerësuar me nivelin 2 “Mirë”, nëpunësja ngre pretendimin se, gjatë këtij procesi, eprori direkt në rolin e zyrtarit raportues, nuk ka ndjekur procedurën e parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore që normojnë institutin e vlerësimit në shërbimin civil, e për pasojë nuk është kryer një vlerësim objektiv për nëpunësen, për këtë periudhë vlerësimi.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të krijuara nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil dhe institutit të vlerësimit të rezultateve në punë.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, vlerësoi se ka dyshime të arsyeshme për parregullsi të lejuara gjatë administrimit të shërbimit civil, e në këto rrethana ka filluar procesin e verifikimit të informacionit nëpërmjet shkresës nr. 600/1 prot., datë 20.6.2025 “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 600 prot., datë 11.6.2025”, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit paraprak të këtij rasti, nga i cili ka kërkuar edhe dokumentacionin përkatës.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, me shkresën nr. 2465/1 prot., datë 26.6.2025, me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës suaj”, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 600/2 prot., datë 27.6.2025, ka dërguar dokumentacionin e plotë në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë

rast, si dhe aktet që pasqyrojnë veprimet administrative që janë kryer gjatë vlerësimit individual të punës për punonjësen në fjalë, për periudhën Korrik-Dhjetor 2024.

Pas analizës dhe verifikimit të dokumentacionit të mësipërm rezulton se:

A. Në lidhje me pretendimin për parregullsi në drejtim të zhvillimit të procesit të ecurisë disiplinore

Nga dokumentacioni i administruar provohet se, punonjësja Pranvera Hajdini me aktin nr.5000/8 prot., datë 16.9.2022 të Departamentit të Administratës Publike, “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, është emëruar në pozicionin “*Shef i Sektorit të Buxhet/Financës*”, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, kategoria e pagës III-a/1.

Në vijim të marrëdhënies së punës në këtë pozicion, nga ana e eprorit direkt të nëpunëses janë evidentuar raste të shkeljeve të etikës në marrëdhëniet e saj me kolegët, për të cilat ka njoftuar edhe Drejtorin e Përgjithshëm të AMP, përmes Memo-s nr. 5059 prot., datë 3.12.2024.

Po kështu, sipas dokumentacionit të dërguar, rezulton se nëpunëses i është tërhequr vëmendja edhe në lidhje me zbatimin e detyrave funksionale. Kështu, përmes komunikimit nëpërmjet postës elektronike, (e-mail), midis eprorit direkt dhe nëpunëses P. Hajdini, vazhdimisht i është kërkuar asaj përmbushja e detyrave, në zbatim të planeve mujore të punës të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe përshkrimit të punës për pozicionin ku ajo ushtron detyrën.

Rezulton se, në shkresën nr. 1851 prot., datë 7.5.2025 “*Relacion mbi shkeljen disiplinore zj. Pranvera Hajdini*”, të Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (eprori direkt), janë evidentuar konkretisht rastet e shkeljeve të disiplinës në shërbimin civil për punonjесen në fjalë, si në fushën e realizimit të detyrave ashtu edhe të mënyrës së sjelljes, e cila përcaktohet si konfliktuale me kolegët.

Sipas shkresës nr. 1851/1 prot., datë 7.5.2025 “*Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor*”, të eprorit direkt, rezulton se nëpunësja është njoftuar se ndaj saj ka filluar procedimi disiplinor për shkelje të detyrave të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore në mbështetje të të cilave funksionon institucioni AMP, në përputhje me nenin 57, pika 4, germa b) dhe c), të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Në këtë shkresë, është caktuar data 23.5.2025, për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar dhe nëpunësja ka nënshkruar se ka marrë njoftim, në datën 8.5.2025.

Me shkresën e datës 19.5.2025 “*Njoftim për zhvillimin e seancës dëgjimore*”, Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e eprorit direkt të nëpunëses, ka njoftuar

sërisht nëpunësen se seanca dëgjimore për të shqyrtuar shkeljen e pretenduar do të zhvillohet në datën 23.5.2025, në orën 10:00, në sallën e mbledhjes së AMP.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën e parashikuar, ashtu si është evidentuar më sipër, është mbajtur edhe procesverbali administrativ i regjistruar me nr. 1851/2 prot., datë 23.5.2025, ku rezulton se, nëpunësja në procedim ka qenë prezent dhe ka pohur faktin që është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore, si dhe ka dhënë sqarimet rreth shkeljeve së pretenduara.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e eprorit direkt, ka hartuar aktin nr. 1851/3 prot., datë 28.05.2025 *“Raport përfundimtar mbi hetimin disiplinor për punonjësin Pranvera Hajdini”* dhe në përmbajtje të tij është arritur në përfundimin se, shkeljet e pretenduara si të kryera nga nëpunësja, i plotësojnë kushtet për klasifikimin e tyre në kategorinë *“shkelje të lehta”*, parashikuar në nenin 57, pika 4 të ligjit për nëpunësin civil.

Në këto rrethana, në zbatim të nenit 58, gërma a), të ligjit për nëpunësin civil, me aktin administrativ nr. 342, (nr.1851/4 prot.), datë 28.5.2025, të eprorit direkt, *“Për dhënien e masës disiplinore një punonjësi të AMP-së”*, është vendosur dhënia e masës disiplinore *“Vërejtje”*, për nëpunësen Pranvera Hajdini, me motivacion: *“Shkelje e rregullave të etikës”* dhe *“Sjellje e parregullt, gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, varësit dhe publikun”*, si aspekte të parashikuara në gërmat b) dhe c), të pikës 4, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Konstatohet se nëpunësja ka marrë njoftim në të njëjtën datë për këtë akt.

Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilin materializohet procedura disiplinore, arrihet në konkluzionin se, nga pikëpamja procedurale janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore; kërkesës për fillimin e ecurisë; vënies në dijeni për këtë fakt të nëpunëses që pretendohet se ka kryer shkeljen; respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar, e për t’u mbrojtur dhe administrimi i provave materiale të nevojshme, e deri në marrjen e vendimit përfundimtar nr. 342, (nr.1851/4 prot.), datë 28.05.2025, të eprorit direkt.

Në këto kushte, akti për dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje”*, në ngarkim të nëpunëses Pranvera Hajdini, **është nxjerrë në përputhje me kërkesat e ligjit** për nëpunësin civil, duke respektuar procedurat që parashikohen gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

B. Në lidhje me pretendimin për parregullsi të lejuara, gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik - Dhjetor 2024:

Nga analiza e materialeve të dërguara nga institucioni, konstatohet se, procesi i vlerësimit të punës për periudhën Korrik-Dhjetor 2024, vlerësuar me nivelin 2 “Mirë”, duhet të ndjekë disa hapa procedurale e materiale të parashikuara posaçërisht nga legjislacioni i shërbimit civil, të cilat do të evidentohen në vijim.

Në bazë të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikës 2, të kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, që ka dalë në zbatim të kësaj dispozite, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik dhe duhet të respektohen të gjitha fazat e tij, ashtu si parashikohen në pikën 12, kreu II, i aktit nënligjor në fjalë:

- Planifikimi, është momenti kur Zyrtari Raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë zyrtari raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karriere, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.

Në rastin në fjalë, kjo fazë e vlerësimit **është** realizuar përmes hartimit çdo muaj, të planeve të punës për Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

- Bisedimet e ndërmjetme, zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku Zyrtari Raportues takohet me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e kryer në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të evidentuar përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.

Në rastin në fjalë, rezulton se gjatë të gjithë periudhës së vlerësimit, midis Zyrtarit Raportues dhe nëpunësve së vlerësuar ka patur komunikim të vazhdueshëm në lidhje me realizimin e detyrave, për dokumentimin e këtij fakti, pasi në dokumentacionin e administruar nga institucioni janë paraqitur edhe disa e-maile të shkëmbyera ndërmjet zyrtarëve.

- Vlerësimi përfundimtar, është një proces që ka të bëjë me vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, duke respektuar afatet e vlerësimit.

Konstatohet se, për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2024, është plotësuar formulari i vlerësimit për nëpunësen P. Hajdini, por në të gjitha rubrikat e tij **mungojnë komentet** e Zyrtarit Raportues.

Në ndarjen D, parashikohet procesi i *nënshkrimit* dhe rezulton se në rastin konkret, formulari është nënshkruar nga të gjithë zyrtarët e ngarkuar nga ligji Zyrtari Raportues (*epriori direkt, G. Sala*), si dhe Zyrtari Kundërfirmues dhe Autorizues (*titullari i institucionit*), por këta zyrtarë nuk kanë përcaktuar nëse janë apo jo dakord me vlerësimin, pasi **nuk kanë plotësuar kutitë përkatëse** të parashikuara në formularin e vlerësimit, e po kështu **mungon** data e nënshkrimit nga Zyrtari Kundërfirmues/Zyrtari Autorizues.

Konstatohet se, nëpunësja e ka nënshkruar formularin në datën 20.1.2025, duke parashtruar se nuk është dakord me vlerësimin dhe arsyet i ka paraqitur në shkresën nr.404 prot., datë 20.1.2025, drejtuar Zyrtarit Autorizues, duke kërkuar rivlerësimin nga ana e tij.

Në vijim të kësaj kërkesë, Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, i cili në rastin konkret **nuk është person përgjegjës** i ngarkuar nga ligji me detyra në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet shkresës nr. 400/1 prot., datë 22.1.2025 *“Ju informojmë për procedurën e vlerësimit të znj. Pranvera Hajdini”*, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të institucionit, i cili është njëkohësisht Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues i nëpunëses në fjalë, duke argumentuar nivelin e vlerësimit 2 *“Mirë”* dhe arsyet që kanë ndikuar në këtë vlerësim.

Ndërkohë, nga ana e Zyrtarit Autorizes **nuk është kryer** procesi i rivlerësimit të rezultateve në punë, pas kërkesës së nëpunëses për rivlerësim, në përputhje me kërkesat e pikës 9, kreu IV, të vendimit nr.109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar.

Referuar problematikës së evidentuar më sipër, sa i takon **mangësi** në plotësimin e formularit në rastin e vlerësimit të nëpunëses, njësia e burimeve njerëzore, duhet të kujdeset në vijim, që në momentin e dorëzimit të aktit të vlerësimit, të kontrollojë plotësimin e të gjithë elementeve të aktit dhe në rast se konstatohen parregullsi, ta kthejë atë për plotësim tek zyrtari vlerësues që i korrespondon problemi që duhet rregulluar, i cili në përputhje me kërkesat e aktit nënligjor, që është Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, duhet të materializojë qëndrimin e tij me komentet dhe argumentet përkatëse.

Më pas, formulari t'i vihet në dispozicion nëpunësit të vlerësuar për t'u njohur me të, si dhe për ta nënshkruar atë, duke respektuar gjithashtu kërkesat ligjore sa i takon afateve të ankimit.

Në këto rrethana, duhet të sjellim në vëmendje të zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, se ky sistem vlerësimi është një proces i rëndësishëm, i cili konsiston në verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirim nga shërbimi, përparimin në hapat e pagës, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik- Dhjetor 2024, për nëpunësen Pranvera Hajdini, të përsëritet nga zyrtarët e përfshirë në këtë proces, duke u kujdesur që të plotësohen të gjitha rubrikat e formularit të vlerësimit.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë institucionit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për realizimin e veprimeve të mësipërme.

2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Ministria e Brendshme, Departamenti i Administratës Publike, si dhe nëpunësja Pranvera Hajdini.

5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Punoi: L. Zhupa

Pranoi: L. Zhupa

Miratoi: A. Basha